

ON A MISSION TO #masterwithErta



Zbulo programin e kursit të implantologjisë për vitin 2025 (from basic to intermediate level)



Study Club

IN IMPLANTOLOGY 2025



Kush është Dr. Erta Xhanari?

Dr. Erta është e specializuar në kirurgjinë implantare dhe reabilitimin protetik. Ajo është Key Opinion Leader për Osstem Europe, bashkëautore e mbi 60 punimeve shkencore dhe lektore ndërkombëtare. Anëtare aktive e Shoqatës Evropiane për Osseointegrimit dhe Akademisë Britanike të Implantologjisë (BAIRD), si dhe hulumtuese aktive në fushën e implantologjisë. Aktualisht ushtron profesionin në klinikën e saj në Tiranë dhe në Itali.

Pse të zgjidhni Study Club?

Rehabilitimi i pacientëve implantarë kërkon shpesh një qasje multi-disiplinare dhe paraqet një sfidë për kirurgun dhe protezistin. Ky kurs mbi implantologjinë do ju ofrojë udhëzime praktike që mund të përdoren lehtësisht në përditshmërinë klinike në mënyrë që t'ju ndihmojë në maksimizimin e estetikës implantare dhe respektimin e indeve përreth implanteve. Planet e trajtimit do zhvillohen në mënyrë të tillë që të ndihmojnë mjekun të zgjedhi mënyrën më të mirë të trajtimit, duke përdorur mënyra mini invazive për të ruajtur sa më mirë anatominë e indeve të buta dhe të lehtësojnë integrimin estetik midis protezës dhe mukozës.

Relatorë të ftuar

Marco Tallarico | Marco Esposito | Doniano Xhanari

Maksimumi
6-8 pjesmarrës

Moduli 1

8-9 Maj 2025

Osteointegrimi dhe planifikimi bazuar në diagnostikimin 3D

Dita 1:

Pjesëmarrësit fillojnë udhëtimin e tyre në implantologji me një hyrje të plotë në bazat shkencore dhe praktike të kësaj fushe. Diskutohet historia dhe konceptet kyçe të osseointegrimit, faktorët biologjikë që ndikojnë në suksesin e implanteve dentare. Trajtohet rëndësia e një planifikimi të strukturuar dhe të kujdesshëm, i bazuar në analiza të sakta dhe diagnostikim tridimensional. Diskutohen anatomia e indeve të buta dhe të forta dhe roli i tyre në përcaktimin e përfitimeve dhe ndërlikimeve që lidhen me përdorimin e implanteve dentare. Analiza e strukturave anatomike nëpërmjet imazheve 3D dhe identifikimi i interesave kirurgjikale janë gjithashtu një pjesë thelbësore e diskutimeve. Prezantohen konceptet moderne të planifikimit të trajtimit, duke përfshirë numrin, dimensionin dhe pozicionimin ideal të implanteve. Moduli gjithashtu përqendrohet te njohja dhe përdorimi i instrumenteve kirurgjikale specifike dhe te zbatimi i protokollit të frezimit, me theks të veçantë në korrektësinë teknike dhe sigurinë klinike.

Aktivitet praktik: Demonstrimi i pjesëve të implantit dhe njohja e kitit kirurgjikal. Vendosja e implanteve në modele kockore me fortësi të ndryshme për të simuluar kushte të ndryshme klinike.

Dita 2:

Diskutohet në detaje raste klinike duke u përqendruar te diagnostikimi dhe plani i trajtimit. Prezantohet një ndërhyrje live ku pjesëmarrësit ndjekin hap pas hapi që nga vizita e pacientit, bërja e grafisë 3D dhe planifikimi virtual në software i rastit klinik. Në përfundim, bëhet një analizë e rastit klinik dhe diskutohet mbi rezultatet e para dhe reflektimet për rastet e ardhshme.

Aktivitet praktik: Vendosja e implanteve në modele kockore duke u bazuar në planifikimin 3D dhe njohja me softwarët modernë të planifikimit. Pjesëmarrësit trajnohen në simulimin e hapave kirurgjikalë të ndjekur gjatë ndërhyrjes live.

Moduli 2

5-6 Qershor 2025

Procedura Kirurgjikale dhe Ruajtja e Alveolit

Dita 3:

Vijojnë me thellimin në aspektet kyçe të përgatitjes së pacientit dhe menaxhimit të procedurave kirurgjikale. Diskutohen në detaje strategjitë për përdorimin e anestezisë lokale dhe teknikat për aplikimin e saj në ndërhyrjet implantare. Vëmendjeje veçantë i kushtohet dizenjimit të lembit duke përdorur qasje të avancuara kirurgjikale dhe suturimit të saktë të indeve. Gjithashtu, trajtohen llojet dhe teknikat e suturave që sigurojnë shërim optimal dhe minimizimin e komplikacioneve.

Aktivitet praktik:

Ushtrime mbi kofshë pule për të praktikuar dizenjimin e lembos dhe teknikat e suturimit. Demonstrim i manipulimeve të ndryshme që pasqyrojnë situata reale kirurgjikale.

Dita 4:

Fokusi zhvendoset te teknikat për ekstraksione atraumatike dhe ruajtjen e alveolit me përdorimin e materialeve moderne të zëvendësimit kockor. Diskutohen avantazhet dhe kufizimet e metodave flapless në raport me lembin tradicional, si dhe menaxhimi i komplikacioneve kirurgjikale dhe zgjedhja e teknikave për raste klinike specifike. Gjatë ditës, pjesëmarrësit ndjekin gjithashtu një ndërhyrje live që demonstroi teknikat dhe konceptet e trajtuara në modul.

Aktivitet praktik: Live Surgery mbi pacientë

Demonstrim i procedurave të ekstraksioneve atraumatike dhe ruajtjes së alveolit. Diskutim mbi strategjitë e ndjekura gjatë ndërhyrjes dhe reflektime mbi raste klinike të ngjashme.

Moduli 3

3-4 Korrik 2025

Protetika mbi Implante – Dizenjimi dhe Materialet

Dita 5:

Fokuset te bazat biomekanike dhe dizenjimi i protetikës mbi implante. Analiza e ndryshimeve biomekanike midis dhëmbëve natyral dhe implanteve. Diskutohen shpërndarja e forcave mbi implante dhe ndikimi i tyre në suksesin afatgjatë. Trajtohen avantazhet dhe kufizimet e kurorave me vidhosje apo cementim. Përzgjedhja e kurorave individuale apo të lidhura dhe sipërfaqet e kafshimit në situata specifike klinike. Përdorimi i cantilever dhe rastet kur ky mund të aplikohet. Një fokus i veçantë i kushtohet zgjedhjes së materialeve të përshtatshme për raste të ndryshme klinike.

Aktivitet praktik: Vendosja e implanteve mbi modele kockore dhe krijimi i një provizori nga vetë pjesëmarrësit. Simulimi i ngarkimit të menjëhershëm dhe diskutimi mbi sfidat dhe teknikat që e shoqërojnë këtë proces.

Dita 6:

Fokuset te trajtimi i rasteve totale me protokolle si All-on-4 dhe All-on-6. Trajtohen strategjitë për planifikimin e trajtimit total. Diskutohet pozicionimi optimal i implanteve për të siguruar stabilitet dhe funksionalitet. Analizohet rëndësia e hapësirës protetike dhe dizajni i bazës së protezës. Prezantohen protokollat për ngarkimin e menjëhershëm dhe të vonuar bazuar në stabilitetin primar të implanteve. Trajtohet menaxhimi i sfidave klinike për raste komplekse me All-on-4 dhe All-on-6.

Aktivitet praktik: Simulimi i trajtimit të rasteve totale me All-on-4 dhe All-on-6 mbi modele klinike. Live surger, analiza dhe diskutimi i rastit klinik për të përforcuar konceptet teorike dhe praktike të mësuara.

Moduli 4

24-25 Korrik 2025

Qasje Multidisiplinare dhe Dokumentimi i Trajtimit

Dita 7:

Diskutohen qasjet më të avancuara për menaxhimin e pacientëve me agenezi dentare përmes një bashkëpunimi multidisiplinar midis ortodontisë dhe implantologjisë. Prezantohen protokollat ortodontike përgatitore për vendosjen e implanteve, duke përfshirë vendimet për hapjen apo mbylljen e hapësirave dentare. Trajtohet përdorimi i implanteve one-piece dhe rastet ku këto janë zgjedhja optimale. Analizohen alternativa të tjera të trajtimit bazuar në sfidat dhe specifikat e çdo pacienti, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit të ekipeve klinike për rezultate të suksesshme.

Aktivitet praktik:

Vendosja e implanteve mbi modele klinike, duke u fokusuar në menaxhimin e hapësirave midis implanteve dhe simulimin e rasteve me agenezi dentare.

Dita 8:

Theksohet rëndësia e fotografisë dentare si një mjet i domosdoshëm për dokumentimin e rasteve klinike. Diskutohet përdorimi i saj për qëllime ligjore, edukative dhe për përmirësimin e praktikës klinike. Prezantohen teknika për fotografimin klinik të saktë dhe krijimin e një arkive dokumentimi që ndihmon në ndërtimin e një baze të fortë të rasteve klinike. Trajtohet rëndësia e standardizimit të dokumentimit për të rritur cilësinë dhe sigurinë në trajtimin e pacientëve.

Aktivitet praktik: Ushtrime për fotografimin klinik me fokus te pozicionimi dhe ndriçimi për rezultate optimale. Diskutohen teknika të personalizuar për raste specifike dhe mënyra e integritit të dokumentimit në praktikën e përditshme.

Moduli 5

11-12 Shtator 2025

Atrofite Posteriore dhe Sinusi Maksilar

Dita 9:

Diskutohet menaxhimi i rasteve të atrofive posterior të nofullave dhe strategjitë më të fundit për rigjenerimin e kockës dhe vendosjen e implanteve në zona me kockë të kufizuar. Prezantohet anatomia e sinusit maksilar dhe procedurat kirurgjikale për ngritjen e sinusit nga kreshta kockore. Analizohen opsionet e trajtimit, duke përfshirë përdorimin e implanteve të shkurtra dhe rolin e overdenturave mbi dy implante. Diskutohen avantazhet dhe kufizimet e secilës qasje, duke përfshirë rastet ku këto alternativa janë më të përshtatshme. Gjithashtu, trajtohet përdorimi i CAS-KIT dhe rëndësia e planifikimit të kujdesshëm për të minimizuar rreziqet dhe për të arritur rezultate optimale.

Dita 10:

Fokusi i ditës është ngritja e sinusit maksilar dhe aplikimi praktik i teknikave të trajtuara në ditën e parë. Pjesëmarrësit ushtrojnë mbi modele për të kryer procedurën e ngritjes së sinusit duke përdorur kit kirurgjikal specifik. Diskutohet në detaje çdo hap i procedurës, nga planifikimi deri te implementimi, duke theksuar sigurinë dhe saktësinë teknike. Dita përfundon me një demonstrim live surgery, ku pjesëmarrësit ndjekin një ngritje të sinusit të kryer nga eksperti. Kjo siguron një mundësi të shkëlqyer për të vëzhguar dhe diskutuar sfidat dhe zgjidhjet në një situatë reale klinike.

Aktivitet praktik:

Ushtrime mbi modelet për ngritjen e sinusit maksilar me përdorimin e CAS-KIT dhe simulimi i vendosjes së implanteve. Live surgery me fokus te ngritja e sinusit dhe trajtimi i një rasti klinik kompleks.

Moduli 6

2-3 Tetor 2025

Menaxhimi i Ndërlikimeve Peri-Implantare dhe Rigjenerimi Kockor

Dita 11:

Moduli i fundit nis me rigjenerimin i drejtuar kockor (GBR) në stomatologji, me theks në parimet biologjike dhe aplikimin klinik. Prezantimet trajtojnë materialet që përdoren në GBR, si membranat, graftet kockore dhe teknikat kirurgjikale për trajtimin e defekteve të ndryshme kockore. Diskutohet rëndësia e GBR-së në trajtimin e pacientëve me humbje kockore dhe ruajtjen e funksionalitetit afatgjatë të implanteve. Aktivitetet praktike përfshijnë ushtrime mbi modele për zbatimin e GBR-së, duke përdorur materiale rigjeneruese dhe teknika të avancuara për arritjen e rezultateve optimale klinike.

Aktivitet praktik:

Pjesëmarrësit do të realizojnë ushtrime mbi modele kockore të kokës së derrit, duke aplikuar teknika të avancuara të GBR-së me materiale rigjeneruese, për të arritur rezultate optimale klinike.

Dita 12:

Mbyllim ciklit e kursit mbi implnatologjine me diagnostikimin dhe trajtimin e ndërlikimeve peri-implantare, duke përfshirë peri-mukozitin dhe peri-implantitin, me fokus në rastet komplekse. Analizohen strategjitë për parandalimin dhe menaxhimin e këtyre ndërlikimeve, si dhe rëndësia e mirëmbajtjes së shëndetit të indeve përreth implanteve. Trajtohen qasjet moderne për restaurimin e funksionalitetit dhe estetikës në rastet e ndërlikuara.

Aktivitetet praktike:

Përfshijnë ushtrime në modele për trajtimin e ndërlikimeve peri-implantare dhe zbatimin e protokolleve terapeutike në situata të ndryshme klinike.

Mbrëmja e mbylljes së kursit dhe dorëzimit të diplomave të lëshuara nga OIC Europe.